

VENDIM
Nr.307, datë 20.7.1992

PËR NDRYSHIMIN E TARIFAVE TË TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë dhe të Ministrisë së Transporteve dhe të Komunikacioneve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Tarifat e transportit qytetar të udhëtarëve në linjat me largësi deri në 9 km, por brenda periferisë së qytetit caktohen 1,5 lekë për vajtje ose kthim, 50 lekë për një biletë pajtimi mujore dhe 140 lekë për atë tremujore. Për nxënësit dhe studentët bileta e pajtimit mujor caktohet 25 lekë dhe e pajtimit tremujor 70 lekë.

2. Tarifat e transportit ndërqytetar në transportin shtetëror të udhëtarëve automobilistik, ujqor (detar e liqenor) dhe në atë hekurudhor rriten mesatarisht 4 herë kundrejt atyre ekzistuese.

3. Ministria e Transporteve dhe e Komunikacioneve, së bashku me Ministrinë e Financave e të Ekonomisë mbi bazën e rritjes së tarifave të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, përcakton çmimet e biletave sipas linjave në transportin shtetëror automobilistik e ujqor, në transportin hekurudhor sipas zonave dhe çmimet e biletave të pajtimit në transportin e punonjësve jashtë periferisë së qytetit, por brenda rrethit.

Për transportin privat ndërqytetar automobilistik dhe ujqor të udhëtarëve, zbatohen çmimet e biletave të miratuara për transportin shtetëror.

Çmimet e biletave mund të ndryshohen mbi bazën e kërkesave që paraqesin subjektet, për efekt të rritjes së shpenzimeve, si rezultat i liberalizimit dhe i rritjes së çmimeve.

4. Çmimet e biletave të linjave ndërkombëtare në transportin automobilistik, detar e ujqor miratohen nga Ministria e Transporteve dhe e Komunikacioneve, në bashkëpunim me organin kompetent të shtetit të huaj, në çastin e lidhjes së marrëveshjes ose të dhënies së licencës.

5. Personat juridikë e fizikë dhe drejtuesit e mjeteve janë të detyruar t'i pajisin udhëtarët me bileta udhëtimi, të cilat përgatiten dhe shpërndahen në mënyrë të përqendruar nga organi i autorizuar nga Ministria e Transporteve dhe e Komunikacioneve.

6. Ministria e Financave dhe e Ekonomisë dhe Ministria e Transporteve dhe e Komunikacioneve, kur tarifat e transportit të udhëtarëve janë me të ulëta se shpenzimet i propozojnë Këshillit të Ministrave miratimin e masës së subvencionit.

Diferenca ndërmjet çmimit të biletave të pajtimit dhe shpenzimeve faktike për transportin e punonjësve jashtë periferisë së qytetit, por brenda rrethit, përballohet nga vetë ndërmarrjet dhe institucionet.

7. Ministria e Transporteve dhe e Komunikacioneve, së bashku me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë nxjerr udhëzimet në zbatim të këtij vendimi.

8. Çdo dispozitë që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 gusht 1992

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi